



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Për :	Sami Lushtaku, Kryetar i Komunës së Skenderajt Ismet Salihu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Skenderajt	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Mirjana Jevtić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Murtezani, U.D i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 21/03/2017
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit Nr. 463/01-0011847 për këmbimin e parcelës nr. 228-22 pronë e paluajtshme e komunës me parcelën nr. 228-28 pronë e paluajtshme e Haki (Gani) Sejdiu	Nr. 020-393
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës	


I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit Nr. 463/01-0011847 për këmbimin e parcelës nr. 228-22 pronë e paluajtshme e komunës me parcelën nr. 228-28 pronë e paluajtshme e Haki (Gani) Sejdiu
I miratuar më datë: 03.03.2017
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 14.03.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Za:	Sami Lushniku, gradonačelnik Opštine Srbica Ismet Salihu, predsedavajući Skupštine opštine Srbica	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS-u Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Mirjana Jevtić, ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u	
Od:	Besim Murtezani, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Dana: 21.03.2017. Br. 020-393
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke br.463/01-0011847 za razmenu parcele br.228-22 koja je opštinska nepokretna imovina, sa parcelom br.228-28 koja je nepokretna imovina Hakija (Gani) Sejdiua	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine Srbica	

Poštovani gradonačelnice,  
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave dostavljen je sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Potvrda zakonitosti odluke br.463/01-0011847 za razmenu parcele br.228-22 koja je opštinska nepokretna imovina, sa parcelom br.228-28 koja je nepokretna imovina Hakija (Gani) Sejdiua
Usvojena dana: 03.03.2017.
Dostavljena MALS-u na razmatranje dana: 14.03.2017.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, procenjuje da je isti **u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvesti punopravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave stoji na raspolaganju opštini za bilo kakvo dodatno objašnjenje u vezi sa ovom procenom.





Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipal of Skenderaj

**Kuvendi i Komunës / Skupština Opštine / Municipal Assembly**

Pas shqyrtimit të propozimit nr. 02-463/02-0007228/17, i datës 13.02.2017, dhe në bazë të nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 11, të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënienë në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 21 të Rregullores së QRK-së, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, të nenit 14, paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), të Statutit të Komunës së Skenderajt nr. 01-110-385, të datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 27.02.2017, miratoi këtë:

**V E N D I M**

- I. Miratohet propozimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personit fizik, **Haki ( Gani ) Sejdiu**.
- II. Sipas pikës I të këtij vendimi:  
Prona e paluajtshme në pronësi të Komunës, parcela/t Kadastrale nr. 228-22, me nr. Certifikatës së pronësisë 81-17, me sipërfaqe prej 43 m2 dhe ngastra Kadastrale nr. 232-4, me sipërfaqe prej 242 m2, me nr. certifikatës së pronësisë 83-17, Zona kadastrale Skenderaj, këmbëhet me pronën e paluajtshme në pronësi të **Haki ( Gani ) Sejdiu**, parcela/t Kadastrale nr. 228-31, nr. Certifikatës së pronësisë nr. 7022, me sipërfaqe prej 100 m2, Zona Kadastrale Skenderaj, ngastra nr. 228-28, me sipërfaqe prej 123 m2, me nr. certifikatës së pronësisë 7022, dhe ngastra nr. 228-26, me sipërfaqe prej 62 m2, me nr. certifikatës së pronësisë 7022, Zona kadastrale Skenderaj.
- III. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV. Këmbimi i cekur në pikën II të këtij vendimi, bëhet për interes publik, për implementimin e projektit të ndërtimit të **Rrugës unazore 2 të Qytetit, Rr. "17 Shkurti" Skenderaj**.
- V. Vendimi do të publikohen në ueb-faqen zyrtare të Komunës dhe tabelën e shpalljeve më të dhënat e pronave të Këmbyera, vlerën e tyre si dhe emrin e pronarit me të cilin është bërë këmbimi.
- VI. Për zbatimin e këtij vendimi, kujdesen: Kryetari i Komunës dhe organi kompetent i Komunës për regjistrimin e pronës së paluajtshme në shfrytëzim.
- VII. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Kopje për:

Kryesuesi i KK-së;  
**Ismet Salihu**

*(Signature)*

1. Arkivi i komunës,
2. DGJKP-së,
3. MAPL-së,
4. Zyrës së kryetarit, dhe
5. Dosjes.

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING			
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
GOVERNA E KOSOVËS / ILI DAVAROSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal			
Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administration			
Ministry of Local Government Administration			
Data / Datum / Date: 03.03.2017			
Njësia organizative / Organizational Unit	Nr. i vlerës / No. of valuation	Shtojca / Attachment	Vlera / Value
- 7	02-303		